

VENDIM
Nr.390, datë 28.6.2007

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.5, DATË 5.1.2002 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PUNËN ME
INFORMACIONIN E KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në titullin e vendimit nr.5, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave, pas fjalës “Sekret shtetëror” të shtohen “... dhe të NATO-s”.

II. Në rregulloren, që i bashkëlidhet vendimit, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të titullit shtohen fjalët “... dhe të NATO-s”.

2. Në pjesën hyrëse “Qëllimi dhe objekti”, pas fjalëve “...” “Sekret shtetëror”...” shtohen “... dhe të NATO-s...”.

3. Në kreun I “Rregulla të përgjithshme”, të bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Zyra e regjistrit qendror të informacionit të klasifikuar të NATO-s, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), dhe zyrat e nënregjistrat të informacionit të klasifikuar të NATO-s, pranë ministrave dhe institucioneve shtetërore, përgjigjen për:

a) krijimin dhe funksionimin e sistemit më të mirë për marrjen, regjistrimin, shpërndarjen dhe transmetimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s;

b) marrjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s nga zyra e nënregjistrat të jashtëm, pranë misionit të Shqipërisë në NATO, përmes zyrës së regjistrat qendror, në DSIK;

c) dërgimin, përmes zyrës së regjistrat qendror, në DSIK, të informacionit të klasifikuar për NATO-n, në zyrën e nënregjistrat të jashtëm;

ç) regjistrimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s në regjistrin përkatës dhe shpërndarjen e tij zyrtare të nënregjistrave të informacionit të klasifikuar të NATO-s, në ministri dhe institucione;

d) marrjen e informacioneve të klasifikuara për NATO-n nga zyrat e nënregjistrave, regjistrimin dhe dërgimin e tyre në zyrën e nënregjistrat të jashtëm;

dh) kontrollin e zyrtare të nënregjistrat të informacionit të klasifikuar të NATO-s, për zbatimin e ligjit dhe të vendimeve për informacionin e klasifikuar;

e) mbajtjen e regjistrave të personave të certifikuar e të personave, që kanë autorizim për klasifikim origjinal, etj.;

ë) planifikimin e veprimtarisë së korrierëve të informacionit të klasifikuar të NATO-s, i cili bëhet në përputhje me nevojat e këtij sistemi.”.

b) Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2, 1/3 dhe 1/4 me këtë përmbajtje:

“1/1. Sistemi i zyrtare të regjistrat të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe pikat e kontrollit, që krijohen në ministri dhe institucione shtetërore, janë përgjegjëse për kontrollin, shpërndarjen e informacionit të klasifikuar të shteteve e organizatave ndërkombëtare dhe për raportimin e shkeljeve e të incidenteve, që mund të ndodhin gjatë marrjes, regjistrimit, shpërndarjes dhe transmetimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Ky sistem mban listën e funksioneve organike, që, në bazë të parimit “nevojë për njohje”, njihen me informacionin e klasifikuar të NATO-s, regjistrin e personave të pajisur me “Certifikatë sigurie” të NATO-s, planin e evakuimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s.

1/2. Informacioni i klasifikuar i NATO-s mbahet në kasaforta, me bravë të koduar, kodet e të cilave ndryshojnë periodikisht, i ndarë nga informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, i prodhuar

nga ministritë dhe institucionet tona shtetërore ose i përfshirë gjatë shkëmbimit me shtetet dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

1/3. Zyra e regjistrimit qendror dhe zyrat e nënregjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s, në ministri dhe institucione shtetërore, në procesin e shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit të klasifikuar të NATO-s, përdorin mjete, pajisje e sisteme kriptografike, të certifikuara përshtatshëm, të cilat u nënshtrohen testeve periodike.

1/4. Sistemi i zyrave të regjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s duhet të përmbushë kërkesat e sigurisë, të përcaktuara nga NATO-ja, dhe standardet e tjera, të parashikuara në këtë rregullore.”.

c) Pikat 3 dhe 6 shfuqizohen.

4. Në fund të pikës 1 të kreut II, “Detyrat e zyrës së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, fjalët “... dhe të informacionit të klasifikuar të NATO-s”, shfuqizohen.

5. Pika 1 e kreut IX, “Rregulla të veçanta”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha